



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 658 Prot.

Lezhë, më 18.01.2021

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____

“Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë.” Mbështetur në ligjin numër 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 germa a, të ligjit numër 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8 i ndryshuar, Ligji 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e shqipërisë” Seksioni IV, Ligji 111/2018 “Për Kadastrën” Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, Ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24, Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, të VKM nr 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar:

PROPOZOJ:

1. Miratimin e listës paraprake të pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësisë Administrative Blinisht - Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

a. Lista e inventarit bashkëngjitur, Fshati Blinisht, Nj. A. Blinisht, Bashkia Lezhë.

2. Paraqitjen e listës së pjesshme paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.

3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Pjerin NDREU

